



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1063/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Sedat Kalimashi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara apelet e parashtruara nga Sedat Kalimashi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, me shenjën ZL.Anr.1063/2017, ZL.Anr.1064/2017 dhe ZL.Anr.1070/2017 të datës 13.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelet ZL.Anr.1063/2017, ZL.Anr.1064/2017 dhe ZL.Anr.1070/2017 me postë, me datë 13.11.2017, nga Sedat Kalimashi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, me të cilat pretendon se votuesit kanë deklaruar se e kanë votuar, por të cilat gjatë numërimit nuk janë më, dhe se dyshon se këto vota gjatë numërimit janë lexuar dhe shënuar në FRK për kandidatë të tjerë, në këto vendvotime: 2013A/01R, 2013A/02R, 2013A/03R, 2013A/04R, 2001A/03R, 2001A/04R, 2001A/06R dhe 2021A/02D. Më tej ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i vendvotimeve të cekura më lartë.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.1063/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për tri apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së apelit, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel gjeti se parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë për të mbështetur pretendimet e tij në apele. Prandaj, apelet i konsideron si të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apele, konstaton se apelet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla apelet i refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1063/2017 më datën 13.11.2017.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*